

VENDIM
Nr.573, datë 28.5.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË BASHKISË CËRRIK TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Cërrik të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 261 (dyqind e gjashtëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1979 (një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Cërrik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Cërrik

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1176-1200	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
1205-1208	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
1167-1173	Prona që përdoren për realizimn e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
1072,1173	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
1-170,172,180,184,186,188,190,191,194,197,200,203-209,211,212,214,216,218-227,229-241,244,246,248,251-307,309-449,451,452,456-458,460,462,463,465-522,528-538,542,543,546,548,551,552,555-574,576,580,582-595,597-698,700-735,746-776,779,782,949,953-957,959-975,978-980,989-992,997,1001-1008,1011-1042,1043	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
1071,1074	Varrezat publike	Në pronësi
1070,1406-1667,1963-1967,1969-	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore,	Në pronësi

1974,1976-1979	hapësira publike, lulishte dhe shërbime publike).	
1068,1069,1163-1165,1224,1225	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
1693-1715,1718,1719,1720	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
1677-1692,1716,1717,1721-1730,1801-1962 (vetëm kanale të treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
1067	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
1050-1065,1075-1160	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
1668-1676	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi